



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2023:116273

Datë: 22.02.2024

Numri i dokumentit: 05356863

CPP.nr.19/24

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, gjyqtari Izet Gërguri, në çështjen juridike përbarimore të kreditorit sh.a.KUR M... J.S.C me seli në Mitrovicë, kundër debitorit H.Sh nga Vushtrria, lidhur me çështjen përbarimore pagimi i Borxhit në shumë prej 999,87 €, për periudhën kohore prej 01.01.2022-31.03.2023, duke rivendosur lidhur me prapësimin e ushtruar nga debitori kundër Urdhrit për lejimin e përbarimit, jashtë seancës, me datën 21.02.2024, e mori këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET PJESËRISHT i bazuar prapësimi i debitorit H.Sh nga Vushtrria, ashtu që SHFUQIZOHET PJESËRISHT Urdhri përbarimor P.nr.128/23 i datës 05.04.2023 i lejuar nga Përbaruesi Privat A.M në territorin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë, përkatësisht për shumën prej 600,80 euro, për periudhën kohore para datës 01.01.2022 për shkak të parashkrimit, ndërsa MBETET PJESËRISHT NË FUQI për pjesën tjetër të borxhit në shumë prej 399,07 € për periudhën kohore prej 01.01.2022-31.03.2023.

II. OBLIGOHET debitori që në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, kreditorit K.U.R. “M...” sh.a, me seli në Mitrovicë në emër të borxhit për shfrytëzimin e shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit për periudhën kohore prej 01.01.2022-31.03.2023, t’ia paguaj shumën prej 399,07 €, me kamatë ligjor prej 8%, duke filluar nga data e paraqitjes së propozimit për përbarim, me datën 05.04.2023 e deri në pagesën definitive të borxhit.

III. Në rast ankese kundër këtij aktvendimi urdhërohet pala ankuese që konform nenit 78 par.1 të LPP-së paraprakisht të paguaj garancinë në të holla në shumë prej 399,07 €, si parakusht për parashtrimin e ankesës, në të kundërtën, gjykata konform nenit 78 par.4 të LPP-së do të konsideroj se ankesa nuk është dorëzuar fare nga pala ankuese.

A r s y e t i m

Përmbartuesi F.Xh, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit të paraqitur me datën 05.04.2023 ka lëshuar Urdhër me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm-ekstrakteve nga librat afarist.

Kundër urdhrin për lejimin e përmbartimit brenda afatit ligjor është ushtruar prapësim nga debitori, me të cilin e kundërshton urdhrin përmbartimor si të pa bazuar. I njëjti ndër të tjera thekson se është ngarkuar me shuma të mëdha imagjinare dhe se borxhi është parashkruar, sipas

dispozitive të nenit 360 par 2 të LDM-së dhe kërkon nga gjykata që të aprovoi prapësimin si të bazuar dhe të anuloi urdhrin përmbartimor.

Kundër prapësimin të debitorit ka paraqitur përgjigje në prapësim kreditori në të cilin ka theksuar se e kundërshton në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit.

Me aktvendimin e kësaj gjykate CPP.nr.71/23 të datës 28.07.2023 është refuzuar prapësimi i debitorit.

Me aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës CAP.nr.1448/23 të datës 17.01.2023 është prish aktvendimi i kësaj gjykate CPP.nr.71/23 të datës 28.07.2023 me rekomandime si në të njëjtin.

Gjykata pas analizimi dhe rivlerësimit të prapësimin të ushtruar nga debitori, gjeti se prapësimi i debitorit gjithësesi është pjesërisht i bazuar.

Lidhur me pretendimin e debitorit se borxhi i kërkuar nga kreditori ka arritur afatin e parashkrimit, gjykata vlerëson se ky pretendim i debitorit është pjesërisht i bazuar dhe atë për shumën prej 600,80 euro për periudhën kohore para datës 01.01.2022 e cila shumë në mënyrë paushalle dhe të pa logjikshme është bart si borxh i muajit prill 2022, andaj gjykata e vlerëson si borxh i parashkruar, ndërsa pjesa tjetër e borxhit në shumë prej 399,07 € për periudhën kohore prej 01.01.2022-31.03.2023 nuk është parashkruar, në pajtim me Ligjin për Marrëdhëniet e Detyrimeve, në nenin 360 par 1 pika 1.1 të LMD-së përcaktohet se: *“Kërkesat të cilat parashkruhen pas një viti: kërkesat për furnizim me energji elektrike, (per nevoja shtëpiake) , ndërsa par 2 përcakton se: afati i parashkrimit fillon të rrjedhë nga fundi i vitit në të cilin arrihen kërkesat për pagesë”*.

Gjykata, lidhur me kumatën ligjore, iu referua nenit 382 par.1 dhe 2 të Ligjit 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve. Ndërsa sa i përket afatit të rrjedhjes se kumatëvonesës, gjykata i referohet mendimit juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës nr.265/20 të datës 01.12.2020, respektivisht par. II, III dhe VI te këtij mendimi juridik dhe gjeti se debitori ka rënë në vonesë në përmbushjen e detyrimit ndaj kreditorit nga data kur është ushtruar propozimi për përmbartim e tutje.

Nga shkaqet e theksuara më lart rezulton se Prapësimi i ushtruar nga debitori është pjesërisht në pajtim me nenin 71 par.1 pika.4 të Ligjit të Procedurës Përmbartimore dhe të njëjtin gjykata e aprovoi pjesërisht si të bazuar, duke zbatuar dispozitën e nenit 73 të LPP-së.

Numri i lëndës: 2023:116273
Datë: 22.02.2024
Numri i dokumentit: 05356863

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË VUSHTRRI
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
CPP.nr.19/24, datë: 22.02.2024

Gjyqtari
Izet Gërguri

KËSHILLA JURIDIKE: *Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes në dorëzim, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.*